



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 26/08**

**Prishtinë, më 22.10.2008, ora 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Myrrete Pantina, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Xhevdet Neziraj, Naser Osmani dhe Riza Smaka.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Agim Krasniqi, Drejtor për buxhet pranë MEF-it, Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit të Kosovës, Mentor Osmanaj udhëheqës i divizionit për buxhet dhe pagesa Afrim Lajqi, Ramiz Krasniqi nga ZRRUM, Hasan Preteni, Xhevat Bekteshi nga AKK, Azem Rexhaj, Zenun Elezaj, Ibush Jonuzi, Isuf Zejna nga KPMM, Tek Shala nga NDI, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, NDI, KDI.

**Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhjet e 6 dhe 9 tetor 2008**
- 3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore për vitin 2009 të organizatave buxhetore në vijim:**
  - 3.1. Kuvendi i Kosovës**
  - 3.2. Agjencioni Kosovar kundër-Korrupsionit**
  - 3.3. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale**
  - 3.4. Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina**

4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/0127/L-029/1 për Inspektionin Bujqësor me raportin e komisionit funksional – Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**
5. **Shqyrtimi i Ligjit për Ngrahje Qendrore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**
6. **Të ndryshme.**

**Kryesuesi**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për rendin e ditës.

**Hajdin Abazi**, kërkoi që në pikën të ndryshme, të diskutohet lidhur me mosrealizimin e të drejtave në pagesë të punëtorëve të administratës së Kuvendit.

**Kryesuesi**, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi se janë komisionet përkatëse për këtë çështje. Përveç kësaj ky Komision do të shqyrtojë vetëm kërkesat e parashtruara me shkrim.

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

### **2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhjet e 6 dhe 9 tetor 2008**

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e 6 dhe 9 tetor 2008, miratohen pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2009**

**Kryesuesi**, lidhur me procesin buxhetor në përgjithësi, kufijtë e tij për vitin 2009, kërkoi sqarime nga drejtori i buxhetit z. Agim Krasniqi.

**Agim Krasniqi**, njoftoi se procesi i përpilimit të buxhetit është në fazën përfundimtare. Qeveria ka paraparë rritje të pagave për stafin civil (duke mospërfshirë punonjësit e arsimit dhe vendimit të Qeverisë për 1900 punëtor që përfitojnë në mënyra tjera). Ekziston edhe një propozim tjetër për lëvizje në skemat sociale, një rritje prej 5 Euro për të gjitha skemat sociale. Buxheti për vitin 2009 planifikohet të jetë 1.79 milion euro, duke mos përfshirë dy pozicionet e KEK-ut (subvencionit për KEK-un, e cila hua duhet kthyer pas fillimit të privatizimit të tij dhe çështja e dytë ka të bëjë me importin e energjisë). Duke i komentuar kërkesat e agjencioneve buxhetore, edhe atyre të pavarura që i përgjigjen Kuvendit, theksoi se të gjitha duhet përfshirë në Buxhetin e përgjithshëm. Kërkesat e tyre i kalojnë kufijtë buxhetor, prandaj MEF-i lidhur me këtë do të bëjë propozime me rekomandime të veçanta që janë më racionale dhe më të realizueshme se sa kërkesat e tyre. Në këtë drejtim është kërkuar edhe nga Kuvendi të ketë zvogëlim të kufijve buxhetor. Z. Krasniqi, theksoi se rekomandimi i MEF-it është që për agjencionet që i përgjigjen Kuvendit, duhet nxjerrë një rregullore nga Kuvendi apo Komisioni që bënë trajtimin e tyre në mënyrë të barabartë.

**Kryesuesi**, kërkoi nga sekretari i kuvendit, të paraqes kërkesën buxhetore të Kuvendit, duke u fokusuar në dallimet që ekzistojnë në mes atyre që ka propozuar MEF-i.

**Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit të Kosovës**, njoftoi se shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit është bërë në Komision dhe grupin punues ka harmonizuar qëndrimet. Duke pasur

parasysh ndryshimet pas pavarësisë e vendit, ndihet nevoja për ngritjen e kapaciteteve të Kuvendit dhe administratës së tij në mënyrë që të mundësohet kryerja e detyrave dhe përgjegjësi të mëdha që dalin para tij. Në këtë drejtim është planifikuar se Parlamenti ynë ka nevojë për krijimin e bashkëpunimit me parlamentet tjera. Shumat e propozuara janë të domosdoshme për funksionimin e Kuvendit, dhe ato janë të arsyetuara mjaftë qartë.

**Kryesuesi**, konfirmoj se komisioni ka analizuar buxhetin e Kuvendit dhe është arritur pajtueshmëria për shumën e përgjithshme. Kjo edhe për faktin se Kuvendi nuk gëzon përkrahjen e donatorëve në masën sa e kishte përpara dhe për shkak të përgjegjësi shtesë që do t'i ketë.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Të harmonizohen qëndrimet në mes Kuvendit të Kosovës dhe MEF-it lidhur me kërkesën buxhetore të Kuvendit për vitin 2009.

### 4. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Agjencionit Kosovar kundër-Korrupsionit për vitin 2009

**Kryesuesi**, theksoi se të gjitha agjencionet e pavarura, të cilave ligji shprehimisht nuk thotë se Kuvendi e miraton buxhetin e tyre, i'u nënshtrohen procesit buxhetor të përgatitur nga MEF-i. Në vazhdim kërkoi sqarime nga përfaqësuesit e AAK, për kërkesën e tyre.

**Hasan Preteni**, njoftoi se kërkesa i'u përmbahen shpenzimeve të realizuara në vitin 2008. Problemi i vetëm që kanë pasur me MEF-i ka të bëjë me kategorinë paga dhe meditje e cila nuk është aprovuar konform kërkesës. Në këtë drejtim kujtojë se kërkesa për kompenzimin e stafit të agjencionit e aprovuar nga ky komision nuk është përfillur nga Kryesia e Kuvendit dhe MEF-i. U ankuar për mosrealizimin e kërkesave të agjencionit nga Qeveria, që po ndikon në realizimin e detyrave që ka ai.

**Kryesuesi**, pyeti për numrin e punëtorëve të paraparë prej 35 vetash a është plotësuar apo është në proces.

**Hasan Preteni**, deri më tani në agjencion janë të punësuar 29 punëtor, ndërsa deri në fund të vitit planifikohet të plotësohet numri prej 35 vetash. Problem paraqet punësimi i ekspertëve në mungesë të stimulimit të pagës.

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi se kërkesës së këtij agjencioni i mungon raporti për rrjedhën e shpenzimeve. Në mungesës të informacioneve për realizimin e shpenzimeve është vështirë për të dhënë opinionin dhe vlerësimin real për kategoritë buxhetore të propozuara për vitin vijues. Nga shifrat e prezantuara, shifet se në kategorinë paga dhe meditje kemi rritje në krahasim me vitin e kaluar, gjithashtu rritje është bërë edhe në kategorinë mallra dhe shërbime. Duke komentuar ankesat e përfaqësuesit të AAK-së për problemet në pranimin e stafit në cilësinë e ekspertëve, theksoi se ky problem po i përcjell të gjitha agjencionet. Prandaj në mungesë të dokumentacionit për rrjedhën e shpenzimeve, nuk mundet të jepet një vlerësimi real për kërkesën në fjalë.

**Kryesuesi**, lidhur me rrjedhën e shpenzimeve buxhetore nuk kemi raport as për agjencionet dhe institucionet tjera. Nga kërkesa e këtij agjencioni shifet se nuk ka rritje të buxhetit, por lëvizje brenda për brenda kategorive.

**Agim Krasniqi**, theksoi se propozimi i AAK është tërheq për shak të mungesës së mjeteve.

**Haki Shatri**, theksoi se problemet janë shfaqur tek pagat, përndryshe kategoritë tjera janë të harmonizuara.

**Besa Gaxherri**, kritikoi për mungesën e rregullatives ligjore, si rezultat i së cilës ky agjencion nuk ka mundësi të përgatit buxhetin në mënyrë të pavarur dhe ai t'i nënshtrohet miratimit në Kuvend (siç ndodh me ZRRE, ART). Znj. Gaxherri theksoi se e shqetëson fakti që rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me këtë Agjencion nuk janë përfillur nga Kryesia dhe Qeveria. U shpreh kundër pretendimeve të Qeverisë për të kontrolluar atë dhe për të ndikuar në pavarësinë financiare. Theksoi se përkrah kërkesën e këtij agjencioni e cila është reale, por në të njëjtën kohë kërkon që ky agjencion të punojë më shumë dhe t'iu shmangët ndikimeve politike. Kërkoj që rekomandimet e Komisionit të merren parasysh me qëllim që të ruhet pavarësia financiare e këtij agjencioni, por edhe agjencioneve tjera të pavarura.

**Shkumbin Demaliaj**, kërkoj nga kryetari të mos merr përgjegjësi dhe obligime kur dihet se nuk po përfillen rekomandimet e këtij Komisioni. Agjencioni nuk do të mund të realizoj kërkesat deri sa Qeveria nuk nxjerr ligjet themelore, si Ligjin e punës dhe Ligjin për shërbyesit civil. Përndryshe tha se ndihet nevoja për mbështetjen financiare të këtij agjencioni, mirëpo rrjedhat e punëve ndikojnë që ai të mos merr qëndrim për të përkrahur apo kundërshtuar këtë kërkesë.

**Kryesuesi**, në përgjigje të parafolësit, theksoi se Komisioni nuk nxjerr rekomandime dhe jo vendime. Për mosrespektimin e këtyre rekomandimeve mund të kërkojmë debat në Kuvend. Rëndësia e AKK është e nivelit të njëjtë me atë të ZRRE-së, prandaj kërkoj që si Komision të rekomandojnë që kategoria e pagave e këtij agjencioni të harmonizohet në MEF.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

## P Ë R F U N D I M

- I. Komisioni mbështet kërkesën buxhetore të Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit për vitin 2009
- II. Agjencioni në bashkëpunim me MEF-in, të harmonizojnë kërkesat tyre lidhur me kategorinë ekonomike paga dhe meditare, duke marrë për bazë edhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa dt. 3.04.2008 dhe 26.05.2008 lidhur me çështjen në fjalë.

### 5. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2009

**Kryesuesi**, theksoi se nga kërkesa e agjencionit në fjalë shifet se rritja e buxhetit të tyre sillet rreth 80 %. Nuk kemi raport lidhur me shpenzimet e buxhetit të tyre. Andaj edhe nuk kemi informacione të mjaftueshme për veprimtarinë e këtij Komisioni.

**Azem Rexhaj**, theksoi se këtë vit do të menaxhohen 333 licenca, si rezultat i këtyre punëve të shtuara ndihet nevoja për mjete shtesë. Punët do të shtohen edhe për faktin se katër punëtorë të huazuar nga ATK-ja, do t'i kthehen asaj. Njoftoi se Laboratori për Gjeologji do të përfundohet këtë, i cili do t'i sjell të hyra buxhetit të vendit, por për kryerjen e punëve duhet punëtorë shtesë. Duke u përgjigjur për mungesën e informacioneve nga Komisioni, theksoi se çdo vit raportet e KPMM-së pos PSSP-së, një kopje është dërguar edhe Komisionit parlamentar për Ekonomi.

**Haki Shatri**, pyeti se a është dërguar me kohë plani i të hyrave dhe shpenzimeve në MEF.

**Myrvete Pantina**, pyeti si ka qenë rrjedha e numrit të punëtorëve prej vitit 2004-2008.

**Azem Rexhaj**, duke i'u përgjigjur z. Shatri theksoi se kanë dërguar kërkesën buxhetore me kohë, dhe pas dëgjimeve buxhetore kanë arritur ta reduktojnë atë në kufijtë e mundshëm. Ndërsa në pyetjen e znj. Pantina theksoi se në fillim kanë qenë të punësuar 57 punëtor ndërsa tani janë 68 (përfshirë edhe katër punëtorët e huazuar nga ATK-ja).

**Agim Krasniqi**, duke komentuar kërkesën e agjencionit në fjalë, theksoi se kemi rritje pothuajse në të gjitha kategoritë. Agjencioni nuk ka nevojë për rritje të numrit të punëtorëve, përveç ristrukturimit të tyre. Janë rritur pagat si dhe janë paraparë shtesa. Kategoria mallra dhe shërbime është rritur për 80%. Karburantet për vetura po ashtu rritje, e njëjta situatë edhe me subvencione. Duhet bërë dallimi në paga ndërmjet të zgjedhurve dhe stafit civil Sugjeroi se me udhëzim të trajtojnë të gjitha agjencionet e pavarura njësoj, duke pasur parasysh edhe përgjegjësitë dhe funksionet e tyre.

**Shkumbin Demaliaj**, theksoi se Qeveria ka marrë hapa verbal në uljen e shpenzimeve të këtij agjencioni. Duhet pasur kujdes me agjencionet që krijojnë të hyra, në këtë të mendohet për përgjegjësitë që bartin ato. Pagat janë të precizuara, ndërsa disa kërkesa tjera si më pak të nevojshme mund të reduktohen. Sa i përket mosraportimit të këtij agjencioni, nuk mund të kritikohet për shkak se në këtë drejtim, kompetencat kanë qenë të rezervuara për PSSP-në dhe kur dihet fakti se një kopje ka pranuar Komisioni për Ekonomi.

**Safete Hadërgjonaj**, duke komentuar kërkesën, theksoi se i mungon raporti për rrjedhën e të hyrave dhe shpenzimeve. Është dashur t'i bashkangjitet një raport të paktën për periudhën nëntëmuajore. Mungon organogrami që paraqet një problem për të vlerësuar nevojën e shfaqur për numrin e ri të punëtorëve. Kërkesa për paga dhe meditje është shumë e lartë. U pajtua me mendimin e drejtorit të buxhetit, që në çështjen e pagave, stafi civil i këtij agjencioni dhe agjencioneve tjera duhet të ketë trajtim të barabartë me stafin civil të nivelit të përgjithshëm. Prandaj si rezultat i mungesës së organogramit, arsyeshmërisë së numrit të punëtorëve, mungesës së rrjedhës së shpenzimeve nëntëmuajore, konstatoi se është vështirë të jepet një vlerësim real për këtë kërkesë.

**Myrvete Pantina**, kërkoi sqarime për rritjen e shpenzimeve në kategorinë paga dhe meditje si dhe kategorinë mallra dhe shërbime. Nuk mund të merret si kriter realizimi i të hyrave për përcaktimin e pagave, sepse po shfrytëzohet pasuria e Kosovës.

**Haki Shatri**, kërkoi që mos të bëhet pengesë miratimi i buxhetit në punën e këtij agjencioni. Pyeti pse është dyfishuar kërkesa për mallra dhe shërbime, a është për shkak nevojave për laborator. Kërkojë një arsyesmëri më të madhe për numrin e punëtorëve.

**Ibush Jonuzi**, thekoi se puna duhet matur me rezultatin e saj. Punët e shtuara kërkojnë shpenzime më të mëdha. Duke ditur vëllimin e punëve që bënë KPMM-ja, është e pamundur me një numër të kufizuar punëtorësh dhe mjetesh t'i përfundojë ato. Për shkak të natyrës së punëve në teren, duhet sigurohen veturat, si dhe të merret parasysh siguria e njerëzve në punë. Premtoi se organogrami do t'iu sigurohet.

**Besa Gaxheri**, theksoi se është ironike që një financier i KPMM-së merr pagë dyfish më të madhe se sa merr drejtori i buxhetit. Fajin e ka Kuvendi që në mënyrë ligjore nuk bënë zgjidhjen e

çështjes së pagave të këtyre agjencioneve. Në anën tjetër rëndësia funksionimit të këtyre agjencioneve, kërkon trajtimin më seriozë të kërkesave të tyre. Krahasoj rastin me ndërmarrjet publike që gëzojnë pavarësi në përcaktimin e buxhetit të tyre, ndërsa këtyre agjencioneve i'u mungon kjo e drejtë, pengesë e së cilës është rregullativa ligjore.

**Haki Shatri**, duhet pasur parasysh veprimtarinë e KPMM-së, por edhe kufijtë buxhetor. Me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve propozoi të formohet një grup punues, i cili deri në mbledhjen e radhës të bëjë propozimet konkrete lidhur me kërkesën e këtij Komisioni.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Zëvendëskryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve lidhur me projektbuxhetin e KPMM-së për vitin 2009, Komisioni krijoi grupin punues, i cili në mbledhjen e radhës do të bëjë prezantimin e propozimeve të veta.

Anëtarët e grupit punues janë:

1. Shkumbin Demaliaj
2. Myrvete Pantina dhe
3. Hajdin Abazi.

### **6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina për vitin 2009**

**Haki Shatri**, kërkoi prezantimin e kërkesës nga përfaqësuesit e ZRRUM-së.

**Afrim Lajqi**, njoftoi se ZRRUM-ja financohet prej taksave dhe licencave. Arsyeja e përcaktimit të pagave është bazuar në dy kritere: një ka të bëjë atë që pagat të jenë të krahasueshme me të licencuarit dhe kriteri dytë që pagat të jenë të krahasueshme me ZRRE-në dhe ART-në. Në vitin 2009 është planifikuar plotësimi i numrit të punëtorëve në 21 nga 19 sa janë aktualisht (një zëvendësdrejtor dhe një ekspert tarifor për mbeturina). Ndërsa arsyeja e ngritjes së mallrave dhe shërbimeve ka të bëjë me shpenzimet e udhëtimit në vendet ku janë krijuar raporte bashkëpunimi. Z. Lajqi theksoi se shpenzimet janë të domosdoshme për të funksionuar kjo Zyre.

**Safete Hadërgjonaj**, duke analizuar kërkesën shifet se kemi informacione më të shumta për dallim prej kërkesave tjera, por megjithatë edhe kësaj kërkesë i mungon raporti për rrjedhën e shpenzimeve. Nga analiza bërë pagave të propozuara, shifet se mesatarja sillet rreth 889 euro, që tregon se stafi civil i këtij agjencioni marrin paga shumë më të larta se sa shërbyesit civil të nivelit të përgjithshëm. Rritje e madhe është paraparë edhe për kategorinë mallra dhe shërbime. Prandaj në mungesë të raportit për rrjedhën e shpenzimeve, dhe kërkesave shumë të larta që tejkalojnë kufijtë buxhetor dhe janë në disproporcion të madh me pagat shërbyesve tjerë civil, nuk duhet të mbështetet kjo kërkesë ashtu siç është prezantuar. Duhet bërë modifikime në shumatat e kategorive të përmendura.

**Hajdin Abazi**, theksoi se pagat e parapara janë të larta, duke ditur edhe aktivitetet që ka ky agjencion si dhe duke pasur parasysh situatën ekonomiko-sociale në vend.

**Haki Shatri**, propozoi sikurse me agjencionin paraprak të krijohet një grup punues i cili deri në mbledhjen e radhës të vie me propozime konkrete lidhur me kërkesën e kësaj Zyre.

**Besa Gaxherri**, kërkoi të përcaktohen kriteret dhe rregullat dhe vendim të bëhet rregullimi i punës dhe çështja e pagesave të Agjencioneve të pavarura.

**Shkumbin Demaliaj**, kërkoi që të mos punohet në grup, por si Komision të japin rekomandimet dhe të bien vendimin që përcaktojnë rregullat standarte për të gjitha agjencionet e pavarura.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Zëvendëskryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

Me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve lidhur me projektbuxhetin e ZRRUM-së për vitin 2009, Komisioni krijoi grupin punues, i cili në mbledhjen e radhës do të bëjë prezantimin e propozimeve të veta.

Anëtarët e grupit punues janë:

4. Safete Hadërgjonaj
5. Kosara Nikolić dhe
6. Haki Shatri.

#### **7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/0127/L-029/1 për Inspektionin Bujqësor me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**

**Haki Shatri**, lexoi raportin e komisionit funksional me amendamente dhe kërkoi të deklarohen nëse konsiderojnë se Projektligji apo amendamentet e propozuara kanë implikime buxhetore.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Zëvendëskryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxjerri këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjit nr. 03/0127/L-029/1 për Inspektionin Bujqësor dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin me amendamentet e Komisionit Funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuar nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **8. Shqyrtimi i Ligjit për Ngrohje Qendrore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**

**Haki Shatri**, lexoi raportin e komisionit funksional me amendamente dhe kërkoi të deklarohen nëse konsiderojnë se Projektligji apo amendamentet e propozuara kanë implikime buxhetore

Pasi që nuk kishte vërejtje, Zëvendëskryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxjerri këtë:

## **REKOMANDIM**

- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Ligjin për Ngruhje Qendrore dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin me amendamentet e Komisionit Funkcional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuar nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

### **9. Të ndryshme**

**Haki Shatri**, njoftoi për kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, por e cila ende nuk është plotësuar me specifikimet siq parasheh ligji, prandaj propozoi që e njëjta t'i kthehet Ministrisë për t'i bërë plotësimin dhe specifikimin e saj.

Njoftoi edhe kërkesën e Shoqatës së Pensionistëve, për të cilën Komisioni mund të rekomandoi se mundësia e realizimit të saj të shikohet nga rezervat e Ministrit të Financave.

Ndërsa për dy disa kërkesat tjera (ZAGJ dhe emërimi i bordit për shqyrtimin e ankesave pranë ATK-së), për shkak shpërndarjes së vonshme të materialeve shtyhen për shqyrtim në mbledhjen e radhës. Me këto propozime u pajtuan të gjithë.

Mbledhja përfundoi në ora 16:00

**Përgatitur nga**  
**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

\_\_\_\_\_  
**Gani KOCI**